



**REPUBLIKA E KOSOVËS /  
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO**

---

**C.nr.222/13**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, gjyqtari Lumni Sallauka, me procesmbajtësen Raxhije Emmini, në kontestin e paditëses T. K. nga fshati K. Komuna e Prizrenit, të cilën me autorizim e përfaqëson av. Pjetër Pergjoka nga Prizreni, kundër të paditurit L. K. nga fshati K. Komuna e Prizrenit, të cilin e përfaqëson av. N. E. nga Prizreni, me objekt të padisë anulimin e pjesëshëm të kontratës mbi dhuratën, vlera e kontestit 500 €, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik, me datën **29.04.2014**, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. REFUZOHET** kërkesëpadia e paditëses T. K. nga fshati K. Komuna e Prizrenit, me të cilën ka kërkuar që “të anulohen pikat 2 (dy) dhe 3 (tre) të Kontratës mbi dhurimin Leg.nr.4012/2012, datë 30.05.2012, e lidhur ndërmjet dhuratëdhënësit-paditurit L. K. dhe dhuratëmarrëses-paditëses T. K., për shkak se i padituri si dhuratëdhënës dhe anëtarët e familjes së tij pas nënshkrimit të kësaj kontrate nuk janë treguar të dinjitetshëm ndaj paditëses T. K., ndërsa në pjesën tjetër kontrata mbi dhurimin të mbetet e pandryshuar, si dhe i padituri t’i paguaj shpenzimet procedurale në shumë prej 513 €”, **si tërësisht e pa bazuar.**

**II. DETYROHET** paditësja T. K. që në emër të shpenzimeve procedurale, të paditurit L. K. t’i paguajë shumën prej 435 €, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

**A r s y e t i m**

Paditësja T. K. nga fshati K. Komuna e Prizrenit, të cilën me autorizim e përfaqëson av. P. P. nga Prizreni, me datën 14.03.2013, ka parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Prizren, kundër të paditurit L. K. nga fshati K. Komuna e Prizrenit, të cilin e përfaqëson av. N. E. nga Prizreni, me objekt të padisë anulimin e pjesëshëm të kontratës mbi dhuratën si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

**1. Pretendimet e palëve ndërgjyqëse**

Paditësja T. K., përmes të autorizuarit të saj av. P. P., në shqyrtimin kryesor ka deklaruar se mbetet në tërësi si në të cekurat në padi dhe kërkesëpadi, duke shtuar se këtu palët ndërgjyqëse janë motër dhe vëlla, ndërsa jetojnë ndaras nga njëri tjetri, secili në shtëpinë e vet në fshatin K. Komuna e Prizrenit. Paditësja T. K. ka lidhur kontratën mbi dhurimin në cilësinë e dhuratëmarrëses sipas të cilës L. K. ia ka dhuruar të njëjtës sipërfaqen prej 90 m<sup>2</sup> në ngastrën kadastrale P-71813035-00655, ndërsa në këtë parcelë paditësja ka ndërtuar shtëpinë qysh në vitin 2001, ku edhe tani banon. Në pikën 2 të kësaj kontrate është theksuar se dhuratëmarrësja është e obliguar që pjesën e paluajtshmërisë së dhuruar ku e ka ndërtuar shtëpinë e vet, të mos e shet, dhuron apo në ndonjë mënyrë tjetër ta tjetërson tek personat e tretë. Ndërsa në pikën 3 të kësaj kontrate është obliguar këtu paditësja që në rast nevojë me njërin nga djemtë e këtu të paditurit sipas zgjedhjes së saj dhe në pajtim me ndonjërin prej tyre të lidh kontratë mbi mbajtjen e përrjetshme. Këtu i padituri si dhuratëdhënës është treguar i pa dinjitetshëm ndaj paditëses si dhuratëmarrëse. Të padinjitetshëm janë treguar edhe djemtë e tij me të cilët paditësja është obliguar që të lidh kontratë mbi mbajtjen e përrjetshme. Të njëjtit kanë filluar ta shajnë dhe ofendojnë paditësen, ndërsa për këtë çështje është duke u zhvilluar procedura penale ndaj këtu paditësit për shkak të vepres penale të kanosjes. Më tutje ka shtuar se pjesa e patundshmërisë që dhuratëdhënësi ia ka dhuruar dhuratëmarrësit është pronë e paraardhësit të ndërgjyqësave D. K., ndërsa i padituri duke shfrytëzuar mungesën e trashëgimtarëve të tjerë të pasurisë e paluajtshme e ka regjistruar në emrin e tij si vëllau më i madh. Përfundimisht, në fjalën e tij të fundit i autorizuarit i paditëses, gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë e paditëses ta aprovojë në tërësi si të bazuar (më gjerësisht referoju fjalës përfundimtare të të autorizuarit të paditëses të dhënë në procesverbalin e shqyrtimit kryesor). Ndërsa i ka kërkuar edhe shpenzimet procedurale dhe atë 135 euro për çdo seancë të mbajtur, 93 euro për padi dhe 15 euro për taksë gjyqësore.

I padituri L. K., përmes të autorizuarit të tij av. N. E. në shqyrtimin kryesor ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë të cekurave në përgjigje me shkrim në padi dhe deklarimeve në shqyrtimet e mbajtura, përmes të cilave e konteston në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, pasi e njëjta është e pabazë dhe në tërësi duhet të refuzohet. Në fjalën e fundit ndër të tjera ka deklaruar se në bazat ligjore që kanë të bëjnë me aprovimin e kërkesëpadiisë paditësja thirret në padenjësi të të paditurit, e që duke marr për bazë cilësinë e të paditurit si dhuratëdhënës, me dispozitat ligjore kjo bazë i takon vetëm dhuratdhënësit e asësesi dhuratëmarrësit siç është këtu rasti i paditëses. Vet paditësja me aktin e lidhjes së kontratës mbi dhurimin Leg.nr.4012/12, në prani të të autorizuarit të saj i ka hartuar pikat e kontratës dhe në bazë të afërsisë dhe dëshirës së paditëses që të ketë një strehë dhe dëshirës së të paditurit që t'ia mundësojë një gjë të tillë vullnetarisht është lidhur kontrata e përmendur më lartë. Intenca e paditëses prej kohësh ka qenë që të bëjë ndryshimin e këtyre dy pikave të kontratës, ndërsa për të arritur këtë "padenjësi" ka sajuar tri kallxime penale për të paditurin dhe një padi për pengim posedimi, duke inskenuar se ka bazë ligjore nën të cilat do të ndryshoheshin pika II dhe III e kësaj kontrate, për t'i ikur obligimit kontraktual familjar, të cilin paditësja me vullnet e ka marr përsipër. Provat e prezentuara nga ana e paditëses nuk provojnë asgjë, pos në konstrukcion për anulimin e pikës II dhe III të kësaj kontrate dhe të përdoret si bazë për shitjen e shtëpisë,

pasi që deri më tani nuk ka qenë në gjendje ta bëjë. Në fund gjykatës i ka propozuar të pas vlerësimin të provave të administruara kërkesëpadinë e paditëses ta refuzojë në tërësi si të pabazuar, ndërsa shpenzimet e procedurës i ka kërkuar për tri seanca nga 135€ dhe për përgjegje në padi shumën prej 30 €.

## *2. Provat e administruara në shqyrtimin kryesor*

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike dhe fakteve vendimtare, gjykata ka administruar provat si në vijim: kontratën mbi dhurimin Leg.nr.4012/2012, datë 30.05.2012, kopjen e planit nr.019/T, datë 04.03.2013, aktvendimin për lejimin e bartjes së pronësisë, datë 13.08.2012, çertifikaten e pronësisë nr. P-71813035-00655-0, datë 24.08.2014, procesverbalin PP.nr.115/2012, datë 12.02.2013 i Prokurorisë Themelore në Prizren, njoftimin e hartuar nga Prokuroria Themelore në Prizren PP.nr.265/13, datë 17.07.2013, si dhe ka dëgjuar palët ndërgjyqëse në cilësi të palës.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartëcekura, në kuptimin e nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se lërkesëpadia e paditëses duhet të refuzohet si e **pa bazuar**.

## *3. Faktet*

Me leximin e kopjes së kontratës mbi dhurimin e patundshmërisë Leg.nr.4012/2012, datë 30.05.2012, gjykata ka vërtetuar faktin se këtu i padituri L. K. si dhuratëdhënës, i'a ka dhuruar këtu paditëses T. K. si dhuratëmarrëse një pjesë të ngastrës nr. P-71813035-00655-0, në sipërfaqe prej 90 m2 ZK K., në të cilën ngastër këtu paditësja e kishte ndërtuar shtëpinë e saj.

Me leximin e kopjes së planit nr.019/T, datë 04.03.2013, aktvendimit për lejimin e bartjes së pronësisë, datë 13.08.2012 dhe çertifikaten e pronësisë nr. P-71813035-00655-0, gjykata vërtetoi faktin se këtu paditëses i është lejuar bartja e pronësisë në pjesën prej 17/128 të ngastrës nr. 00655-0 dhe tani e njëjta evidentohet si pronare pjesës së kësaj ngastre.

Me leximin e procesverbalit PP.nr.115/2012, datë 12.02.2013 të Prokurorisë Themelore në Prizren dhe njoftimin e hartuar nga Prokuroria Themelore në Prizren PP.nr.265/13, datë 17.07.2013, gjykata vërtetoi faktin se raportet në mes këtu palëve ndërgjyqëse janë të acaruar dhe për këtë shkak organi i përmendur më lartë ka ngritur aktakuzën PP.nr.4193/12 datë 08.05.2013, ndaj të paditurit L. K., për veprën penale kanosje, e cila është në procedim e sipër në Gjykatën Themelore në Prizren.

Paditësja T. K. gjatë dëshmisë së dhënë në shqyrtimin kryesor në cilësi të palës, ka dhënë versionin e saj në lidhje me çështjen e kontratës mbi dhuratën, bisedat paraprake me të paditurin, ndërtimin e shtëpisë së saj në ngastrën e

dhuruar, si dhe problemet që cilat kanë lindur më vonë në mes tyre (më gjerësisht referoju procesverbalit të shqyrtimit kryesor të datës 08.04.2014).

I padituri L. K. gjatë dëshmisë së dhënë në shqyrtimin kryesor në cilësi të palës, ka dhënë versionit e tij në lidhje me çështjen e kontratës mbi dhurimin, diskutimet paraprake me paditësen, si dhe problemet që kanë lindur në mes tyre (më gjerësisht referoju procesverbalit të shqyrtimit kryesor të datës 08.04.2014).

#### **4. Ligji i aplikueshëm**

Në rastin konkret gjykata ka zbatuar dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve të ish Jugosllavisë të vitit 1978, pasi që marrëdhënia e detyrimeve në mes palëve ndërgjyqëse ka lindur para hyrjes në fuqi të Ligjit të ri për Marrëdhëniet e Detyrimeve Nr.04/L-077 (kontrata është lidhur në vitin 2012). Kjo parashihet me nenin 1057 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, i cili shprehimisht thotë: *“Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen në marrëdhëniet e detyrimeve që kanë lindur para hyrjes në fuqi të këtij ligji”*. Ndërsa paditësja padinë e ka parashtruar në gjykatë me datë 14.03.2013.

Gjithësesi për nevoja krahasimore do të përmendim edhe dispozitat e Ligjit Për Marrëdhëniet e Detyrimeve Nr.04/L-077, i cili ka hyrë në fuqi nga data 01.01.2013, pasi që ligji i vjetër i vitit 1978 nuk përmban dispozita të cilat shprehimisht e rregullojnë kontratën mbi dhuratën. Në këtë drejtim neni 536 parag. 1 i LMD-së ndër të tjera pëcakton se: *“Me kontratën për dhuratën një person (dhuratëdhënësi) merr përsipër që pa shpërblim të bartë të drejtën e pronësisë apo ndonjë të drejtë tjetër tek dhuratëmarrësi apo në ndonjë mënyrë tjetër të pasurojë dhuratëmarrësin nga llogaria e dhuratëdhënësit, si dhe dhuratëmarrësi të jep pëlqimin për një gjë të tillë”*. Më tutje neni 542 i LMD-së rregullon çështjen e revokimit të kontratës së dhuratës për shkak të varfërimit të dhuratëdhënësit, ndërsa neni 543 parag. 1 i LMD-së rregullon revokimin e kontratës mbi dhuratën për shkak të mosmirënjohjes së thellë si në vijim: *“Dhuratëdhënësi po ashtu mund të revokojë kontratën për shkak të mosmirënjohjes së thellë nëse pas lidhjes së sajë dhuratëmarrësi sillet me dhuratëdhënësin apo me ndonjë person të afërt të tij në atë mënyrë që sipas parimeve themelore të moralit do të ishte e padrejtë për dhuratëmarrësin të mbante atë që ka marrë me dhuratë”*. Ndërsa neni 546 i LMD-së ka paraparë kohën brenda së cilës kontrata e dhuratës mund të revokohet, e që është afati prej një viti nga dita kur dhuratëdhënësi ka mësuar për arsyet e revokimit.

#### **5. Vlerësimet faktike dhe juridike të gjykatës**

Pas analizimit dhe vlerësimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provat e administruara në lidhje me këtë çështje kontestimore, gjykata erdhi në

përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e pa bazuar dhe për këtë e njëjta u desh të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Gjykatës i rezultoi se këtu palët ndërgjyqëse me vullnet të lirë dhe pa kurrfarë presioni e kanë lidhur kontratës mbi dhurimin Leg.nr.4012/12, datë 30.05.2012, ku janë pajtuar për objektin dhe kushtet tjera të kësaj kontrate, përfshirë këtu edhe kushtet e parapara me nenit 2 dhe 3 të kësaj kontrate. Nga përmbajtja e kësaj kontrate rezulton se palët ndërgjyqëse kanë lidhur të ashtuquajturën dhuratë me dekret (donatio sub modo), e cila është një lloj i veçantë i kontratës së dhurimit. Kjo kontratë ekziston kur dhuruesi i jep diçka të dhuruarit, meqë ky i fundit duhet të kryejë veprime të caktuara në llogari të dhuratëdhënësit ose personit të tretë. Nga kjo rrjedh se në rastin konkret dhuratëdhënësi ka rezervuar për vete të drejtën ose për dikë tjetër (njërin prej djemëve të tij), ku e urdhëron dhuratëmarrësen (paditësen) në rastin konkret që mos të merr veprimet e caktuara në lidhje me ngastrën e dhuruar (mos ta shes), si dhe në anën tjetër e ka obliguar të njëjtën që me njërin prej djemëve të tij të lidh kontratë mbi mbajtjen e përjetshme. Këto kushte të kontratës siç rezulton edhe nga provat e administruara i ka pranuar në tërësi këtu paditësja si dhuratëmarrëse. Në këtë lloj të kontratës të drejtën për të kërkuar përmbushjen e obligimeve të marra me këtë kontratë me dekret (nëse nuk përmbushet vullnetarisht nga dhuratëmarrësi) e kanë dhuratëdhënësi apo trashëgimtarët e tij nëse është e përfshirë ndonjë dobi ndaj tyre, por jo edhe dhuratëmarrësi. Ky i fundit eventualisht mund të mos e pranoj dhuratën (mund të mos pajtohet me kushtet e kontratës) apo edhe të kërkojë përmbushjen e saj nëse nuk përmbushet vullnetarisht nga dhuratëdhënësi, apo mund të kërkoj anulimin e kontratës mbi dhuratën nëse objekti i dhuratës përmban të meta juridike apo materiale, e që në rastin konkret nuk kanë ekzistuar këto të meta, por paditësja me vullnet të lirë e ka pranuar dhuratën së bashku me kushtet e cekura në kontratë.

Gjithashtu nuk qëndrojnë pretendimet e paditëses se duhet të anulohen neni 2 dhe 3 i kontratës mbi dhuratën, për faktin se këtu i padituri dhe fëmijët e tij janë sjellë në mënyrë të padinjitetshme ndaj saj. Kjo për faktin se marr parasysh këtu natyrën e kësaj kontrate, atëherë të drejtën për të kërkuar anulimin e kontratës së dhuratës mbi bazën sjelljes së padinjitetshme, apo nga shkak i mosmirënjohjes (exceptio ob ingratitudinem) e ka vetëm dhuratëdhënësi e asesi dhuratëmarrësi. Kjo çështje tani është rregulluar edhe me nenin 543 parag. 1 të ligjit të ri të Marrëdhënieve të Detyrimeve, i cili i jep mundësinë dhuratëdhënësit që të kërkoj revokimin e dhuratës nëse konstaton se dhuratëmarrësi sillet padinjitetshëm ndaj tij dhe familjarëve të tij. Kjo është e kuptueshme nëse marrim parasysh natyrën dhe qëllimin e kontratës së dhuratës, pasi që është dhuratëdhënësi që pranon t'i bartë ndonjë të drejtë apo send nga pasuria e tij dhuratëmarrësit, ndërsa me këtë veprim të njëjtit edhe i zvogëlohet pasuria e tij për pjesën e dhuruar, ndërsa pasuria e dhuratëmarrësit shtohet kur t'i bashkangjitet pasuria e dhuruar. Kështu që eventualisht nëse plotësohen kushtet ligjore këtu paditësja si dhuratëmarrëse mund të hjekë dorë në përmbushjen e obligimeve që dalin nga kontrata e dhurimit dhe të ja kthej të paditurit si dhuratëdhënës atë që ka marr nga ai, por jo edhe të kërkojë anulimin e pjesërishtëm të kësaj kontrate siç ka kërkuar me padi (mbi bazën e sjelljes së keqe të dhuratëdhënësit), pasi siç e cekëm edhe më lartë kjo e drejtë i takon vetëm dhuratëdhënësit.

Për sa i përket pretendimeve tjera të paditëses që kanë të bëjnë me raportet e acaruar në mes palëve ndërgjyqëse, për të cilat edhe Prokuroria Themelore në Prizren ka ngritur aktakuzë kundër të paditurit L. K. për veprën penale kanosje (aktakuza PP.nr.4193/12 datë 08.05.2013), gjykata konsideron se e njëjta procedurë nuk mund të ketë kurrfarë ndikimi në zhvillimin dhe përfundimin e kësaj procedure civile. Kjo për faktin se në rastin konkret është paditësja si dhuratëmarrëse që ka parashtruar padi për anulimin e pjesërishëm të kontratës për dhuratën Leg.nr.4012/12, datë 30.05.2012, mbi bazën e sjelljes së keqe të dhuratëdhënësit-paditurit, e jo i padituri si dhuratëdhënës. Nëse do të kishte kërkuar i padituri anulimin e kësaj kontrate mbi bazën e sjelljes së keqe apo mosmirënjohjes nga ana e dhuratëmarrëses, atëherë eventualisht konstatimi i fajësisë së dhuratëmarrësit në raport me dhuratëdhënësit mund të kishte ndikim në vendosjen meritore të kësaj çështje. Gjithësesi vlen të theksohet se procedura penale ende nuk ka përfunduar dhe i takon gjykatës penale që të jep verdiktin për këtë çështje.

Në lidhje me pretendimet e paditëses se ngastra e cila ka qenë objekt i dhurimit ka qenë pronë e paraardhësit të palëve ndërgjyqëse, por i padituri padrejtësisht e ka regjistruar në emër të tij si vëllau më i madhë, gjykata të njëjtat nuk i pranoi. Kjo për faktin se këto pretendime nuk mund të kenë ndikim në përfundimin e kësaj procedure, pasi që të njëjtat nuk janë objekt shqyrtimi, ndërsa paditësja ka mundësi ligjore që eventualisht të inicojë procedurë të re gjyqësore ndaj të paditurit për të kërkuar pasurinë trashëgimore.

Gjykata gjithashtu ka vlerësuar edhe provat e tjera materiale të administruara, përfshirë këtu edhe deklaratat e palëve ndërgjyqëse të dhëna në shqyrtimin kryesor në cilësi të palës, por erdhi në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen meritore të kësaj çështje juridike kontestimore.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 452.1 të LPK-së, ku gjykata e obligoi palën paditëse që në emër të shpenzimeve procedurale ti paguaj palës së paditur shumën prej 435 € dhe atë për tri përfaqësime nga 135 € dhe 30 € për përgjegje në padi.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e duke u bazuar në nenin 143.1 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**C.nr.222/13, datë 29.04.2014**

**Procesmbajtësja**  
**Raxhije Emini**

**Gjyqtari**  
**Lumni Sallauka**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.